



QKRM Qendra Kosovare për Rehabilitimin
e të Mbijetuarve të Torturës
KRCT The Kosovo Rehabilitation
Center for Torture Victims

RAPORTI VJETOR 2023



Ky publikim mbështetet nga:

**SIGRID
RAUSING
TRUST**

RAPORTI VJETOR 2023



PËRMBAJTJA

06	Mesazh nga Drejtorja Ekzekutive
08	Rreth QKRMT-së
12	Puna dhe ndikimi ynë Viti 2023: Histori Suksesi Rrugëtim drejt suksesit
16	Programi i rehabilitimit
18	Programi të Drejtave të njeriut dhe Avokimit
20	Publikimet dhe ndarja e njohurive
26	Trajnime dhe shkëmbim njohurish
30	Avokim dhe Ndërgjegjësim
36	Datat e rëndësishme
42	Mbështetja dhe inkurajimi i punës sonë
44	QKRMT frymëzim për të tjerët
46	Struktura qeverisëse Lidershipi dhe menaxhmenti Rrjetëzimi
50	Donatorët

MESAZH NGA DREJTORJA EKZEKUTIVE

// Të nderuar përfitues, miq, bashkëpunëtorë dhe mbështetës, Viti i kaluar ka qenë një sfidë dhe një rrugëtim i paharrueshëm për ne. Nëpërmjet programeve rehabilituese, avokuese dhe edukuese, kemi lënë gjurmë thelbësore. Disa nga sukseset më të rëndësishme përfshijnë triumfin historike, *kur e mbijetuara e parë e dhunës seksuale nga koha e luftës fitoi drejtësinë*, dhe ndaj dhunuesit u konfirmuar dënimi me 13 vjet burgim nga Gjykata Supreme. Ky ishte hap i rëndësishëm në reziliencën e të mbijetuarës. Arritja e drejtësisë ka fuqizuar të mbijetuarën dhe ka motivuar shumë të tjera që të ndjekin rrugën e saj dhe të kenë besim tek vetja dhe institucionet e drejtësisë.



Një rrugëtim tjetër i suksesshëm, është dëmshtëpërblimi i parë për viktimën e përdhunimit në burg. Në sajë të një mbështetje këmbëngulëse 10 vjeçare të QKRMT-së, përfituesi ynë arrin që të triumfojë ndaj shtetit dhe të marrë kompensimin për shkak të dështimit të institucioneve korrektuese që t'i ofrojnë mbrojtje dhe siguri.

Gjithashtu, këtë vit, në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Refugjatëve, ne organizuam ekspozitën *“Lule kundër luftës”* dhe fjalimi emocionues i autores Lyudmila Makey (refugjate nga Ukraina) na bëri të ndjehemi krenarë dhe të përkujtojmë misionin tonë: ndryshimin e jetës së njerëzve.

Gjatë vitit 2023, kemi ofruar mbi 1000 shërbime rehabilituese, mjekësore dhe ligjore për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës, refugjatët dhe personat e privuar nga liria. Përtej kësaj, QKRMT është shndërruar edhe në një qendër të rëndësishëm humlues, me 11 publikime të ndryshme studimore.

Bashkë me ekipin tim, vazhdojmë me përkushtim të plotë të ndjekim misionin tonë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe arritjen e drejtësisë. Viti që vjen do të jetë një vit jubilar për ne, shënojmë një çerek shekull punë dhe përkushtim, ku planifikojmë të thellojmë angazhimin tonë dhe të ndikojmë në heqjen e afatizimit të aplikimit për njohjen e statusit të viktimit dhe ngritjen e aktakuzave të reja për rastet e dhunës seksuale të ndodhura gjatë luftës në Kosovë.


Drejtësia është e domosdoshme për paqe dhe qetësi.

Faleminderit për mbështetje! //

Dr. Feride Rushiti

RRETH QKRMT-SË

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT është organizatë jo qeveritare, me një traditë të gjatë të punës në komunitet. E themeluar në vitin 1999, QKRMT ka kultivuar dhe ruajtur karakterin e një organizate e cila ofron trajtim dhe rehabilitim mjekësor, psikologjik e social për të mbijetuarit e torturës. Gjithashtu, përgjatë tërë ekzistencës së saj, QKRMT në vazhdimësi ka punuar në ngritjen e kapaciteteve të stafit të saj dhe sektorit publik me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më profesionale për të gjitha grupet e synuara. QKRMT në vazhdimësi është rritur si organizatë, duke zgjeruar mandatin e saj në monitorimin e të drejtave të njeriut në vendet e duke përfshi monitorimin e qendrave korrektuese, qendrave të paraburgimit, qendrave të mbajtjes në stacionet policore, institucionet e shëndetit mendor dhe të kujdesit social. Për më tepër, QKRMT ofron shërbime psiko-sociale për azil kërkuesit dhe refugjatët në Kosovë, përderisa personave të riatdhesuar u ofrohet edhe këshilla juridike. Së fundmi, QKRMT avokon fuqishëm për realizim të plotë të të drejtave të përfituesve të saj, me theks të të mbijetuarve të dhunës seksuale nga lufta e fundit në Kosovë.



Vizioni

Një shoqëri e lirë nga tortura ku të mbijetuarit e dhunës gjejnë mirëkuptim, mbështetje dhe njohje që u mundëson të zhvillojnë një jetë të përmbushur. Një shoqëri ku tortura dhe forma të tjera të trajtimit veçanërisht degradues dhe çnjerëzor janë çrrënjësuar. Një shoqëri ku secili i mbijetuar gjen mbështetje, ku asnjëri prej tyre nuk ndjehet i turpëruar, ku vetë shoqëria është e hapur, pranuese dhe mirëkuptuese. Një shoqëri që kupton sesi diskriminimi çon në dhunë dhe kujton se si urrejtja çoi në akte çnjerëzore. Një shtet që i trajton të gjithë qytetarët me respekt, qëllimi i të cilit është të mbrojë të drejtat e njeriut dhe të mos i shkelë kurrë ato.

Misioni

Misioni ynë është fuqizimi i viktimave dhe transformimi i tyre në qytetarë aktiv duke i ndihmuar në përballje me traumat dhe duke kontribuar në zhvillimin e një sistemi institucional të mbështetjes, njohjes dhe llogaridhënies.



Dinjiteti: Ne besojmë në dinjitetin e çdo personi. Ne besojmë se asnjë person, në asnjë situatë, askund, nuk duhet t'i nënshtrohet torturës dhe trajtimit çnjerëzor. Ne besojmë se të gjithë njerëzit, në më të mirën dhe në më të keqen e tyre, meritojnë të trajtohen me respektin dhe dinjitetin më të thellë, për shkak të të qenit njerëzor.

Ndjeshmëria dhe solidariteti: besojmë se ndjeshmëria dhe solidariteti ndërtojnë komunitete më të mira dhe kohezive. Besojmë se kur njerëzit i nënshtrohen një padrejtësie të rëndë, është çështje e përgjegjësisë shoqërore për ta trajtuar atë. Besojmë se asnjë person që i është nënshtrohet torturës dhe dhunës nuk duhet të lihet i vetëm në përballje me pasojat. Jemi të përkushtuar të jetojmë në ndjeshmëri dhe solidaritet me të mbijetuarit dhe të promovojmë këto vlera përmes veprave që bëjmë.

Drejtësia dhe përgjegjësia: Ne besojmë se asnjë akt torture apo dhune nuk duhet të kalojë pa u adresuar. Të gjithë individët dhe grupet që shkelin të drejtat më themelore të një personi tjetër, ose cenojnë dinjitetin e një personi tjetër, duhet të mbajnë përgjegjësi. Ky është një mesazh për shoqërinë në tërësi, sundimin e ligjit, edukimin, si dhe luftimin e stigmatizimit ndaj të mbijetuarve.

Gjithëpërfshirja: Besojmë në vlerat e gjithëpërfshirjes dhe kohezionit social. Kemi qenë dëshmitarë dhe ende përballemi me pasoja të dhunës me urrejtje të justifikuar nga de-humanizimi dhe diskriminimi. Jemi të përkushtuar të sigurojmë që shoqëria jonë sot të jetë një shoqëri që respekton dhe pranon të gjithë njerëzit, pavarësisht nga identitetet etnike, fetare, racore, seksuale apo të tjera.



PUNA DHE NDIKIMI YNË

Viti 2023: Histori Suksesi



E MBIJETUARA E PARË QË GJEN DREJTËSINË

Një fitore tjetër e të mbijetuarve dhe QKRMT-së

Në vitin 2023, Gjykata Supreme vërtetoi dënimin e Z.V. i cili ishte dënuar me 13 vjet burgim për krimet e dhunës seksuale gjatë luftës. Kjo është një fitore për të gjithë të mbijetuarit dhe për QKRMT-në, e cila përveç ofrimit të rregullt të shërbimeve psikosociale, ka bashkëpunuar ngushtë me prokurorinë speciale dhe ka mbështetur viktimën në të gjitha etapat e procesit. Kjo fitore i ka inkurajuar të mbijetuarit tjerë në rrugëtimin e tyre dhe përpjekjet e mundimshme për drejtësi.

Historik i shkurtër i procesit

Më 5 korrik 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, kishte dënuar me 10 vjet burgim të akuzuarin Z.V. për krimet e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Pas ankesës së Prokurorisë Speciale ndaj Aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special i Gjykatës së Apelit ndryshoi këtë aktgjykim duke e rritur dënimin ndaj të akuzuarit nga 10 në 13 vjet burgim. Mbrojta e të akuzuarit kishte paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, dhe Gjykata Supreme e refuzoi këtë kërkesë dhe përfundimisht e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, sipas të cilit Z. V. ishte dënuar me 13 vjet burgim.

“Pas 25 viteve po çlirohem dhe po e ndjej lirinë!”

– e mbijetuarja e cila fitoi drejtësinë.

Rrugëtim drejt suksesit

10 VJET PUNË E PËRKUSHTIM: PËR HERË TË PARË KOMPENSOHET VIKTIMA E DHUNIMIT NË BURG

Që nga viti 2014, QKRMT ka mbështetur viktimën e cila është dhunuar seksualisht në burgun e Dubravës, të cilin përveç shërbimeve rehabilituese, gjithashtu e ka përfaqësuar atë në proceset gjyqesore në kërkim të drejtësisë deri në nëntor të vitit 2023.

Në shtator të vitit 2023, Gjykata themelore në Prishtinë pjesërisht ka aprovuar kërkesën e viktimës dhe ka njohur të drejtën e tij për kompensim për shkak të dështimit për të vepruar në përputhje me përgjegjësitë legale në ofrimin e sigurisë në institucionet korrektuese për keqtrajtimin e tij në vitin 2014. Sipas vendimit të Gjykatës, Ministria e Drejtësisë, si përgjegjëse e Shërbimit Korrektues të Kosovës, është e obliguar t'i kompensoj viktimës dëmtimin mental, dhimbjet fizike dhe t'i kompozoj shkeljen e dinjitetit dhe nderit të tij.

Ky është rasti i parë ku gjykata i bën përgjegjëse institucionet e shtetit për dështimin e tyre në raport me shkeljen e të drejtave të viktimës. Ky rast do shërbej si referencë për raste të tjera, në rast të shkeljes së të drejtave, ndaj individëve me liri të privuar.

“Pas traumës... e gjeta veten të braktisur dhe të humbur: Humba të fejuarën dhe miqtë, Mendova se kisha arritur fundin. Por ndihma e QKRMT-së më nxori në jetë dhe më bëri më të fortë. Për shkak të kontributit të tyre, unë tani jam më mirë, ata ishin gjithmonë pranë meje; ata kanë qenë një ndihmë e madhe për mua, duke më dhënë forcën të pranoj se jeta duhet të vazhdojë” – deklaratë nga klienti.



PROGRAMI I REHABILITIMIT

Në kuadër të programit të rehabilitimit, shërbimet tona bazohen në qasjen holistike dhe trajtojnë të gjithë përfituesit në aspektin individual, familjar dhe atë të komuniteti. Programi ynë i ndihmon të mbijetuarit dhe familjet e tyre të rivendosin shëndetin dhe dinjitetin, si dhe të rindërtojnë jetën e tyre dhe të kontribuojnë në shoqëri.

Në këndvështrimin tonë të përgjithshëm rehabilitimi është **psikologjik** dhe **fizik**. Prandaj, programi i shërbimeve tona bazohet në një ekip multidisiplinar dhe pakoja jonë e shërbimeve ofron:

Këshillim duke u fokusuar në vlerësimin e nevojave dhe sfidave të shëndetit mendor me të cilat përballen përfituesit tanë gjatë gjithë jetës, duke përfshirë sfidat sistematike si paragjykimet dhe stigmatizimet e përjetuara në familjen e tyre, komuniteti dhe shoqëria;

Rehabilitimi psikologjik synon të lehtësojë vuajtjet psikologjike dhe të përmirësojë funksionimin psikologjik dhe social të përfituesve. Një ekip i specializuar i përbërë nga psikiatër, psikologë dhe punonjës socialë ofron këto shërbime në baza ditore: Psikoterapi individuale, Psikoterapi në grup, Terapi familjare, terapi ekspresive-kreative, terapi konjitive biheviore dhe terapi me ekspozim të zgjatur;

Kujdesi mjekësor diagnoza, trajtimi dhe recetat; dhe

Shërbimet psikosociale për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore, përfshijnë mbështetje emocionale për të ndihmuar në rikuperimin psikologjik nga trauma; menaxhimi i rasteve, mbështetja dhe avokimi për të ndihmuar të mbijetuarit të kenë qasje në shërbimet e nevojshme; dhe mbështetje për riintegrimin social.

Terapi

475

individuale

89

Terapi Familjare

47

Terapi Grupore

165

Fizioterapi

Shëndeti mendor dhe mbështetje psikosociale:

115

azilkërkues dhe refugjatë në Kosovë kanë përfituar nga shërbimet psikosociale

63

Raste të reja të grave dhe vajzave të riatdhesuara kanë marrë trajtim psikologjik, shëndetësor dhe juridik

Njohje të statusit dhe mbështetje:

53

të mbijetuarve iu është njohur statusi i viktimës

66

të identifikuar të rinj të dhunës së luftës

Udhëzime dhe mbështetje:

19

Mbështetje dhe fuqizim ekonomik të riatdhesuarve, grave dhe vajzave refugjate

22

paketë për ushqim bazik dhe higjienë

60+

Paraqitje mediatike, përfshirë radio, televizione, gazeta, revista dhe dokumentare në frekuenca kombëtare dhe ndërkombëtare.

PROGRAMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE AVOKIMIT

Ky program udhëheq, koordinon dhe planifikon të gjitha aktivitetet e ndërlidhura me misionin për promovimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, me theks të veçantë për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria dhe të mbijetuarve të luftës. Ky program organizohet përmes këtyre nën-programeve: Monitorimi i vendeve të privimit nga liria; Ndihma juridike falas; Avokimi dhe Drejtësia Tranzicionale:



Monitorimi i vendeve të privimit nga liria

• • • QKRMT realizon monitorim të rregullt në vendet e ndalimit: qendrat korrektuese dhe të paraburgimit, qendrat e mbajtjes në stacionet policore dhe të kujdesit social si dhe promovon praktika dhe standarde legjislative për mbrojtjen dhe avancimin e respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria. Gjatë këtij viti janë monitoruar **mbi 20 vende të privimit nga liria**. QKRMT monitoron edhe seancat gjyqësore. Gjatë vitit 2023 janë monitoruar **10 seanca gjyqësore**.

- Ndihma juridike falas** ••••• QKRMT që nga viti 2006 ofron ndihmë juridike falas për përfituesit e saj sa i përket çështjeve ligjore. Përfituesit dhe familjarët e tyre përfitojnë nga shërbimet të cilat ofrohen nga juristët dhe avokatët e angazhuar në njësinë për ndihmë juridike.
- Avokimi** ••••• Përmes letrave dhe fushatave avokuese, QKRMT ka kërkuar ndryshimet ligjore për zgjatjen e afatit për njohjen e statusit të viktimave të dhunës seksuale ndaj të gjitha instancave shtetërore deri **në korrik 2023, Kuvendi i Kosovës aprovoi ligjin me të cilin është shtyre afati për aplikim deri në Maj 2025.**
- Drejtësia Tranzicionale** ••••• Që nga viti 2019, QKRMT, merret me dokumentimin e rasteve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, synon përfshirjen e të gjitha rasteve, pa dallim etnie, që kanë përjetuar dhunë seksuale në kontekstin e luftës në Kosovë.

Shërbime

1300+

Raste të dokumentuara të dhunës seksuale gjatë luftës

100+

Shërbime Juridike për të mbijetuarit e dhunës seksuale

20+

20+ Vizita monitoruese në vendet e privimit të lirisë

20+

Letra Avokimi

PUBLIKIMET DHE NDARJA E NJOHURIVE

Viti 2023 ishte vit i publikimeve. QKRMT në vitin 2023 ka publikuar 11 **botime** në disa kategori siç janë, hulumtime akademike, raporte, dokumente politikash, libër rrëfimesh dhe manuale pune. Këto publikime janë të një rëndësie të veçantë, ngaqë bazohen në hulumtime empirike dhe vëzhgime praktike. Të gjitha këto publikime mund t'u shërbejnë për pedagogët universitar, hulumtuesit shkencor, praktikuesve profesional dhe publikut të gjerë.

Raport Monitorimi 2022

*Të Drejtat e Njeriut në Institucionet Korrektuese në Kosovë – Ky raport ka të bëjë me punën njëvjeçare të sektorit për të drejtat e njeriut në QKRMT, në monitorimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në shërbimin korrektues në nivel të shtetit, gjegjësisht, në burgje, qendra të paraburgimit dhe qendrat e mbajtjes në stacione policore. Ky raport është gjithëpërfshirës dhe përmbledh përshkrimet e 14 vizitave monitoruese. Publikimit të këtij raporti i ka paraprirë një **tryezë** diskutimi me akterët kyc: drejtorja e Shërbimit Korrektues dhe drejtorët e burgjeve, mbi gjetjet dhe rekomandimet e raportit..*

Manuali i Terapisë Familjare: Adresimi i Ndikimit të Traumës në Familje

Është një publikim tejet specifik dhe i rëndësishëm në lidhje me traumën dhe terapinë e saj. Është specifik ngaqë frytet e këtij manuali bazohen në leximet teorike dhe vëzhgimet e drejtpërdrejta

empirike të nxjerra nga shërbimet që ofrojnë ekipi i psikologëve brenda QKRMT-së në trajtimin e familjeve të traumatizuara. Ky manual ofron edhe një kontekst lokal, social dhe kulturor të shpërfaqjes së traumës dhe trajtimin e saj, dhe si i tillë do t'i shërbejë të gjithë profesionistëve, studiuesve dhe studentëve të fushës së psikologjisë dhe shkencave sociale. Ky hulumtim është realizuar në bashkëpunim me Institutin Dignity, Spitalin Universitar të Kopenhagës dhe Universitetin Monash në Australi, dhe mbështetur nga: Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë. Këtij hulumtimi iu është shoqëruar edhe **konferenca**, organizuar nga QKRMT, me titull: "A mundet terapia familjare të rikthejë ndryshimet epigjenetike që mund të jenë të shkaktuara nga efektet e Çrregullimit të Stresit Pas Traumatik (ÇSPT) amnor dhe traumës ndër brezore?" ku janë prezantuar rezultatet preliminare ku kanë marrë pjesë studiues, ligjërues vendor dhe ndërkombëtar.

Drejtësia për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale Gjatë Luftës

Analizë e dispozitave legjislative të ligjit penal dhe ligjit të procedurës penale për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë . Përbri këtij botimi është organizuar **konferencë** me Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Prokurorinë Speciale dhe Policinë e Kosovës në adresimin e rasteve të krimit të dhunës seksuale gjatë luftës në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Zëra të pa dëgjuar

Rrëfime të burrave mbi tejkalimin e traumës së dhunës seksuale në luftë - Është libri i tretë me rrëfime, pas librave "Unë dua të dëgjohem", "Përtej dhimbjes drejt guximit", i cili përmban dhjetë

rrëfime të burrave të mbijetuar të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë. Ata flasin guximshëm për të kaluar e tyre të trishtë, fëmijërinë, luftën, traumën e përjetuar gjatë luftë dhe gjendjen sociale dhe shpirtëore të pasluftës. Me rastin e promovimit të këtij libri është organizuar një konferencë ndërkombëtare. Në këtë konferencë u diskutua për përvojat dhe vështirësitë e burrave dhe djemve që i mbijetuan dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, si dhe u promovua libri “ Zëra të pa dëgjuar: Rrëfime të burrave mbi tejkalimin e traumës së dhunës seksuale në luftë” i botuar në bashkëpunim me forum ZFD. Në këtë konferencë u publikuan edhe rezultatet e hulumtimit të përbashkët mes QKRMT dhe Universitetit të Leuvenit me temën “Të jetuarit me “barrë” të mbijetuarit burra të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”.

16 Ditët e Aktivizmit

Zëra nga kampet e refugjatëve – është një broshurë e shkruar si udhëzues por me një gjuhë narrative që i dedikohet atyre që janë detyruar të ikin për shkak të dhunës me bazë gjinore por edhe formave tjera të armiqësisë si ksenofobia, varfëria, krimi, frika dhe lufta që në një far forme ka rrezikuar sigurinë e tyre. Promovimi i këtij libri në Prishtinë ishte pjesë e fushatës 16 ditore të aktivizmit të organizuar nga KRCT. Në promovimi mori pjesë dhe autorja e librit znj. Ethel Manyaka.

Puna me migrantë, refugjatë, të rikthyer dhe të riatdhesuar në Kosovë (modul trajnimi)

Është publikim i dedikuar punëtorëve social dhe psikologëve që ka bërë me traumën dhe shpërfaqjet e saja psiko-fizike dhe njohuritë për punën e përditshme me migrantë, refugjatë, të rikthyer dhe riatdhesuar. Edhe pse ky publikim i dedikohet trajnimit për

kategoritë e sipërpërmendura, ai mund të gjejë përdorim të frytshëm edhe nga një publik më i gjerë. Krahas këtij publikimi është organizuar edhe trajnimi me të njëjtën temë.

Adresimi i gjuhës së urrejtjes dhe drejtësisë tranzicionale në hapësirën qytetare (POLICY PAPER)

Është publikim i cili analizon trendet aktuale në hapësirën publike lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe drejtësinë tranzicionale, i cili nxjerr në pah tkurrjen e hapësirës publike për të gjithë ata/ato që merren me drejtësinë tranzicionale dhe adresojnë llogaridhënien për krimet e kaluara.

Dokumentimi i Krimeve të Dhunës Seksuale gjatë luftës në Kosovë- Metodologjia e Dokumentimit

Ky manual është një dokument që ofron një përshkrim hap pas hapi të procesit të dokumentimit të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë dhe shërben si udhërrëfyes për institucionet dhe OJQ-të që merren me dokumentimin e krimeve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë dhe jashtë saj.

E drejta për të vërtetën - Viktimat pa emër

Ky është ribotim i përditësuar i raportit të të dhënave të përgjithshme të nxjerra nga dokumentimi i dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Në këtë raport janë përfshirë të dhënat për 1080 raste. Ribotimi i përditësuar ofron një mundësi për të përmirësuar dhe zgjeruar më tej gjetjet fillestare, duke thelluar kuptimin për kontekstin, motivet dhe pasojat e këtyre krimeve për të gjithë të mbijetuarit, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike dhe gjinore.

Përditësimi i vazhdueshëm i këtij raporti sinjalizon një angazhim të vazhdueshëm për kërkimin e së vërtetës dhe drejtësisë, duke siguruar që viktimat dhe të mbijetuarit të marrin njohjen që meritojnë.

Mbështetja familjare në ballafaqimin me traumat e luftës

Udhëzues praktik – Ky udhëzues ofron një seri udhëzimesh për të parandaluar traumatizimin dytësor anëtarëve të familjes së individëve të traumatizuar. Gjithashtu, është udhëzues për ndryshimin kognitiv dhe të sjelljes, i nevojshëm për t'u përshtatur me procesin e mbështetjes së të mbijetuarit të traumës ose për përballimin e stresit nga traumatizimi dytësor. Pas hartimit të këtij udhëzuesi, QKRMT ka organizuar edhe tryezë diskutimi për të prezantuar këtë udhëzues.

Analizë ligjore: Trajtimi institucional i torturës dhe keqtrajtimit

Është një fletë informuese dhe dokumentuese ku paraqitet një vështrim ndaj ngjarjes që ka ndodhur në Qendrën për të Moshuar “Orenda” në Pejë gjatë nëntorit 2022. Në këtë fletë informuese analizohen dhe parashtrohen shkeljet dhe lëshimet në trajtimin e të moshuarës nga ana e institucioneve shtetërore, obligimet e institucioneve shtetërore për respektimin e standardeve të vendosura nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.



TRAJNIME DHE SHKËMBIM NJOHURISH

Seminare •••• Gjatë vitit 2023, QKRMT ka realizuar seminar me 18 gazetarë nga Ukraina dhe Afganistani, seminare me të rinj nga komuna të ndryshme të Kosovës; si dhe ka participuar me panelistë në seminarin e nivelit të lartë në kuadër të rrjetit HOPE ku ka ligjëruar për parandalimin e radikalizmit dhe jetësimin e programeve rehabilituese për personat e kthyer nga zonat e konfliktit.

Tryeza diskutimi •••• Një formë tjetër e promovimit edukues rreth objektivave dhe qëllimeve, QKRMT-ja ka organizuar disa tryeza të diskutimit, në formë kritike janë diskutuar, temat si fuqizimi i grave; tryezë diskutimi me përfaqësues të institucione dhe shoqërisë civile nga Ukraina në lidhje me të mbijetuarit e dhunës seksuale, tryezë diskutimi me përfaqësuesit institucioneve të shërbimeve korrektuese dhe tryeza në qytete të ndryshme të Kosovës në lidhje me ndërgjegjësimin ndaj stigmës ndaj të mbijetuarve seksuale, mbështetjen, rifuqizimin dhe riçintegrimin e tyre në shoqëri.



Ngritja e • • • • QKRMT gjatë vitit të kaluar, ka mbajtur me dhjetëra aktivitete e punëtori në funksion të edukimit, informimit dhe avancimit të punëtorëve institucional në lidhje me temat e ballafaqimin dhe trajtimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale të luftës, mbi traumën dhe terapinë individuale dhe familjare; punëtori në lidhje me trajtimin e personave të riatdhesuar dhe refugjatëve. Përfituesit nga këto punëtori janë punëtorët social, zyrtarët komunal të komuniteteve për kthim. Gjithashtu, QKRMT ka realizuar punëtori ku përfitues janë zyrtarë të Ministrisë së Brendshme, në lidhje me ofrimin e mbështetjes ndaj refugjatëve dhe azilkërkueseve; si dhe punëtori për ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale nga koha e luftës.



Studentë, • • • •
pedagog
të huaj në
QKRMT

QKRMT vitin e kaluar ka pritur dhe mbajtur ligjërata për grupe të ndryshme studentësh ndërkombëtar. Qendra ka pritur studentë të programeve të ndryshme edhe atë, studentët e programit post-diplomik për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci nga *Universiteti i Vjenës dhe Veneçias; studentët e Universitetit Shtetëror të Floridas dhe pedagogë nga Universiteti James Madison të Virginia – SHBA*. Në këto takime është prezantuar puna e Qendrës në ofrimin e shërbimeve mjekësore, psikologjike dhe avokuese, avancimin e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe parandalimin e torturës, dokumentimin e krimeve të luftës, si dhe qasjen në drejtësi për të mbijetuarit e dhunës seksuale nga koha e luftës.



Vizitë • • • •
studimore
në Zvicër

Drejtorja e QKRMT-së, znj. Feride Rushiti, gjatë vitit 2023, kishte ligjeruar në Gjenevë të Zvicrës, mbi përvojën e Kosovës në aspektin e praktikave të reperacionit administrativ, përparësitë dhe sfidat e këtij procesi. Një pjesë të ligjërimit të saj, ia kishte kushtuar konfliktit në Ukrainë, ku ndarja e praktikave të Kosovës në këtë drejtim, ka shërbyer si model për krijimin e një legjislacioni urgjent të përkohshëm për reperacion në Ukrainë.

Takim në
Washington
DC

• • • • Drejtorja Ekzekutive e QKRMT-së Feride Rushiti, së bashku me drejtoren e QPDG-së Kadire Tahiraj, përfaqësuesen nga Rrjeti i grave, Deputete të Kuvendit të Kosovës si dhe Kabinetin e Presidencës ka marrë pjesë në takimin e pestë të *Rrjetit të grave për paqe dhe siguri (WPS) në Washington D.C.* Në hapjen e Seancës Plenare të Nivelit të Lartë që është mbajtur në Departamentin e Shtetit të ShBA-së, znj. Rushiti ka ndarë me pjesëmarrësit eksperiencën e saj si lidere në komunitetin ËPS, sfidat dhe punën e QKRMT-së drejt fuqizimit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, promovimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, si dhe rëndësinë e luftimit të stigmatizimit dhe paragjyqimeve shoqërore.



AVOKIM DHE NDËRGJEGJËSIM

Në korrik 2023, Kuvendi i Kosovës aprovoi ligjin me të cilin është shtyre afati për aplikim deri në Maj 2025. QKRMT, përmes fushatave avokuese, ka kërkuar ndryshimet ligjore për zgjatjen e afatit për njohjen e statusit të viktimave të dhunës seksuale ndaj të gjitha instancave shtetërore. **QKRMT fton në mundësinë e aplikimit të paafatizuar për njohjen e statusit të viktimave seksuale të luftës.**

QKRMT NGREH ZËRIN PËR TË DREJTAT E TË BURGOSURVE

Akomodimi pa kategorizim i të burgosurve është trajtim i padinjëtshëm. Drejtorja Ekzekutive, Feride Rushiti, ka mbajtur qëndrimin se ky lloj akomodimi i përzier është në kundërshtim edhe me dispozitat ligjore në fuqi, sidomos për të paraburgosurit. Menaxhimi i këtyre kategorive të të burgosurve me të burgosurit tjerë është i vështirë edhe për stafin e qendrave korrektuese. Kjo përzierje e të burgosurve sjell shumë herë konflikte dhe dhunë mes të burgosurve.



SHËNIMI I 24 VJETORIT

Në shënimin e 24 vjetorit të themelimit, QKRMT ndau çmimin vjetor “Çmimin për Guximi Vasfije” (Vasfije Courage Award), për të shprehur mirënjohjen ndaj personave të shquar, që me punën dhe angazhimin e tyre, kanë dhënë kontribut të çmuar në mbështetje të kauzës së të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Këtë vit, QKRMT në përkujtim të jetës dhe veprës së Dr. Shukri Gërxhaliut do ta nderojë atë me “Çmimin për Guxim – Vasfije” (Vasfije Courage Aëard), dedikimi dhe përkushtimi i të cilit për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë dhe pas luftës ishte i patejkalueshëm. “Çmimin për Guximi Vasfije” (Vasfije Courage Aëard) iu nda Dr. Shukri Gërxhaliu, mjek në luftë dhe në paqe, i cili dha kontribut të çmuar për drejtësi. Në ceremoninë e ndarjes së çmimit, mori pjesë edhe Presidentja e Republikës së Kosovës znj. Vjosa Osmani, e cili foli për mbështetjen e vazhdueshme institucionale për të mbijetuarit e dhunës seksuale nga koha e luftës; kontributin e pashoq të Dr. Gërxhaliut në ofrimin e ndihmës profesionale dhe njerëzore për të mbijetuarit; si dhe përkushtimin që QKRMT-ja ka treguar ndaj të mbijetuarve të dhunës seksuale qysh nga koha e menjëhershme e pasluftës duke shërbyer si derë e vetme ku të mbijetuarat gjetën rehabilitim, ngushëllim dhe shërim për vuajtjet që kishin përjetuar.

Në përvjetorin e 24-të të Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës u lansua projekti RECONNECT : Rehabilitimi dhe Riintegrimi i të Miturve - Viktima të Dhunës Seksuale, përmes ofrimit të Shërbimit të Rehabilitimit dhe Ndihmës Ligjore dhe Ngritjes së Kapaciteteve të Institucioneve Shtetërore – i cili synon rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve-viktima të dhunës seksuale në Kosovë.



ZËRI I TË MBIJETUARVE DËGJOHET NË KOMISIONIN EUROPIAN

Zonja Shyrete Tahiri Sulimani e mbijetuar dhe aktiviste në QKRMT, me ftesë të Këshillit Ndërkombëtar për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (IRCT), ka marrë pjesë në **Konsorciumin ndërkom-bëtar #UnitedAgainstTorture** e organizuar nga Komisioni Evropi-an. Në këtë ngjarje znj.Sulimani mbajti fjalim para të pranishmëve, ku tregoi përvojën e saj duke përfaqësuar të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë dhe qindra mijëra zëra të heshtur anë e mbanë botës si pasoj e këtij krimi.

“Puna ime e avokimit si aktiviste dhe e mbijetu-ar është sa e thjeshtë aq edhe komplekse në të njëjtën kohë. Unë përdor zërin tim, përvojën time dhe historinë time për të rritur ndërgjegjësimin për nevojat e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës. Të ndash historinë nuk është e lehtë, sepse ti po ndan dhimbjen që është brenda teje dhe është dhimbje që nuk shërohet kurrë, është dhimbje që duhesh të mësohesh të jetosh me të dhe për fat të keq, edhe fëmijët e mi janë ndikuar gjithashtu.”

Shyrete Tahiri Sulimani



DATAT E RËNDËSISHME

14 Prilli

14 Prilli Dita Memoriale e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë – Historike, për herë të parë shënohet 14 Prilli si Ditë Memoriale e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë. QKRMT, së bashku me Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës dhe organizatat anëtare të Platformës “Bëhu Zëri Im”, organizuan marshin në mbështetje të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Zyrtarizimi i kësaj dite nderon të mbijetuarit, ngrit vetëdijen për fuqizimin e tyre dhe shënimi i kësaj date mban të gjallë ndërgjegjen tonë në dokumentimin e të vërtetës dhe thirrjes kolektive në përkujtimin e historisë.

QKRMT që nga viti 2019 ka kërkuar që 14 Prilli të njihet si Ditë e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale nga koha e luftës, ku më pastaj me propozimin e presidentes së Republikës së Kosovës znj. Vjosa Osmani, me datën 12.04.2023 Qeveria e Republikës së Kosovës mori vendim që 14 Prilli të jetë Ditë e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë.



20 Qershori

Dita Botërore e Refugjatëve u shënuar përmes organizimit të një ekspozite “Lule kundër luftës” me veprat artistike të refugjates gazetare dhe piktores ukrainase Lyudmila Makey. Me anë të kësaj ekspozite, organizatorët përçuan mesazhin, për rëndësinë e mbështetjes së refugjatëve në vendet ku ata ndodhen si dhe i ndërgjegjësimin të opinionit publik për qëndrueshmërinë dhe forcën e refugjatëve në mbarë botën.

Të jetosh me shpirt të plagosur

Ndoshta s'ju besohet, unë nuk kam vizatuar si e vogël, por tek kur jam rritur dhe shpesh pyetem se pse kështu? As deri para një viti, s'kisha mund me imagjinu se pikturat e mia do të shfaqen në kryeqytetin e Kosovës. Realiteti brenda të cilave po ndodhin janë tragjike fatkeqësisht. Rusia dëshiron të shkatërrojë popullin dhe vendin tim. Kur filloi lufta, m'u përmbys bota dhe humbi ngjyrat. Por në Prishtinë takova Feride Rushitin një person të mrekullueshëm. Ajo më mësoi si të jetoj me shpirt të plagosur. Ajo më tha material për kreativitet. Më ndërroi jetën dhe m'i ktheu ngjyrat. Unë fillova të pikturoj përsëri, Prishtina më frymëzoi. Universi im ideal ku nuk ka luftë dhe dhembje, janë lulet. Dua t'i ndihmoj kolegëve të zënë robër nga Rusia. Prandaj vendosa t'i shes pikturat e mia. Koleget e Melitopolit Iryna Levchenko dhe burri i saj, në veçanti, të cilët po mbahen peng në burgjet ruse. Paratë e tubuara, do t'ia dhuroj Unionit Kombëtar të Gazetarëve të Ukrainës t'i ndihmojnë kolegëve të burgosur. Këtë ekspozitë ia dedikoj Ukrainës dhe e falënderoj Kosovën për mbështetjen dhe dashninë e saj, dhe të gjithë juve që jeni këtu. Kjo do të thotë se ju mbështesni Ukrainën.

Ju falemnderit!

Fjalimi i Lyudmila Makey




19 Qershori

Dita Ndërkombëtare për Eleminimin e Dhunës Seksuale në Konflikt u shënuar përmes organizimit të një tryeze të titulluar: “E drejta për njohje: Ndikimi i mungesës ligjore dhe afatizimit të aplikimit në procesin e njohjes për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”. Në këtë tryezë morën pjesë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të institucioneve të tjera. Shënimi i kësaj date është një rikujtim i rëndësishëm për të ndërgjegjësuar botën për nevojën urgjente për masa efektive për të mbrojtur të drejtat e viktimave dhe për të ndëshkuar kryesit e krimeve të tilla.



26 Qershori

Dita Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara në **Mbështetje të Viktimave të Torturës**, u shënua përmes një aktivitet avokikues ku drejtroja e QKRMT-së, Dr. Feride Rushiti takoi Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës z. Glauk Konjufca. Në këtë takim, znj. Rushiti parashtroi çështjen e kufizimit të afatit për aplikim për njohjen e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale nga koha e luftës në Kosovë.



MBËSHTETJA DHE INKURAJIMI I PUNËS SONË

Në vitin që lamë pas, Qendrën tonë e kanë vizituar anëtarët e Komisionit për Legjislacion të Parlamentit të Danimarkës, të udhëhequr nga Kryetar i këtij Komisioni **z. Steffen Larsen** si dhe Ambasadorin e Danimarkës në Kosovë. Në këtë takim Drejtorja e QKRMT-së znj. Feride Rushiti shpalosi anagzhimin dhe punën më shumë se 24 vjeçare të QKRMT-së, duke i dhënë një theks të veçantë përkushtimit në parandalimin e torturës si dhe sundimin e ligjit në raport me qendrat korrektuese në Kosovë. Në takim u diskutua edhe marrëveshja në mes të Kosovës dhe Danimarkës për transferimin e të burgosurve në Kosovë. Znj. Rushiti njoftoi mysafirët mbi konkluzionet e Konferencës Ndërkombëtare që QKRMT kishte organizuar më 2022, pikërisht mbi temën e transferimit të të burgosurve në Kosovë dhe marrëveshjen në mes dy shteteve.

Ambasadorja kanadeze për Kroaci dhe Kosovë **znj. Jessica Blitt** vizitë në QKRMT-në. Ambasadorja Blitt është informuar me punën e QKRMT-së në përgjithësi, dhe me përparimin dhe ndikimin e projektit "Rehabilitimi dhe Riintegrimi i të Miturve - Viktima të Dhunës Seksuale, përmes ofrimit të Shërbimit të Rehabilitimit dhe Ndhmës Ligjore dhe Ngritjes së Kapaciteteve të Institucioneve Shtetërore" në veçanti.

Ambasadori Finlandez në Kosovë **z. Nissinen** ka vizituar QKRMT-në, ku është njoftuar me qëllimet, aktivitetet sukseset dhe sfidat e QKRMT-së në fushën e rehabilitimit dhe riintegrit të të mbijetuarve të dhunës seksuale. Ai po ashtu është njoftuar në lidhe me fushatat për promovimin e të drejtave të njeriut dhe eksperiencën e QKRMT-së në mbështetjen psiko-sociale dhe shëndetësore të grave dhe vajzave të riatdhesuara dhe refugjate në Kosovë.



QKRMT frymëzim për të tjerët

QKRMT shpreh falënderimin e thellë për Enver Robelli, autorin e librit 'Rrëfime të shkurtra për një ditë të gjatë', i cili fitoi çmimin 'Rexhai Surroi'. Vendimi i tij i admirueshëm për t'i dhuruar honorarin e këtij libri Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e Mbijetuarve të Torturës shërben si një shembull frymëzues i sjelljes humanitare dhe ndihmesës së vyer për të gjithë që kanë kaluar nëpër përvojat më të dhimbshme. Ndihe mi mirë për kontributin dhe përkushtimin e Enver Robellit në ndihmë të një qëllimi të rëndësishëm si rehabilitimi dhe riintegrimi i të mbijetuarve të torturës në Kosovë. Kjo tregon një ndjesi të thellë dhe një përkushtim të vërtet të tij, në përmirësimin e kushteve për njerëzit në nevojë.





BËHU *ZËRI* IM
BE MY *VOICE*
BUDI MOJ *GLAS*

Struktura qeverisëse

Qeverisja e brendshme e QKRMT parasheh një platformë për të gjitha proceset menaxhuese në QKRMT. Qasja demokratike përbën thelbin dhe parimin fundamental të Organizatës, dhe reflekton në vendim-marrje, transparencë si dhe llogaridhënie për të gjitha aktivitetet e realizuara Brenda fushëveprimtarisë sonë. Kësisoj, QKRMT vepron dhe mbetet besimplotë karshi mandatit të saj, qëllimeve si dhe vizionit dhe misionit, të cilat janë të definuara në të gjitha dokumentet relevante të organizatës.

Kuvendi i Anëtarëve përbën organin më të lartë qeverisës të QKRMT-së dhe ka përgjegjësitë kryesore për politikën dhe çështjet financiare të organizatës, si dhe përgjegjësi tjera në: aprovimin dhe amendamentimin e statutit të QKRMT-së, zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të Bordit, aprovimin e raporteve të Bordit, gjithashtu sipas propozimit të Bordit zgjedh dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv. Gjithashtu, Kuvendi mund të delegojë përgjegjësi tek Bordi, ndonjë organ tjetër, apo zyrtarë të organizatës.

Bordi i QKRMT, përcakton mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të organizatës. Në kuadër të programeve të QKRMT, Bordi analizon, hulumton, sugjeron, propozon dhe jep rekomandime, dhe veçanërisht është kompetent për: shqyrtimin dhe aprovimin e programeve, të ardhurat dhe shpenzimet, pastaj aprovimin e akteve juridike të organizatës, nominimin e Drejtorit Ekzekutiv, si dhe aprovimin e planeve dhe raporteve vjetore.

Me qëllim sigurimi të një modeli sa më efektiv qeverisës, Organizata ka ndërtuar një grup mekanizmash, që janë përkthyer në politika dhe procedura: (a) monitorimi i realizimit të aktiviteteve në kuadër të programeve (b) definimi i qartë i linjave raportuese dhe matja e performancës (c) mbikëqyrja e manaxhmentit (d) përkufizimi i roleve dhe përgjegjësive për secilin të punësuar, dhe njoftimi i tërë

stafit për këtë (e) përditësimi i politikave dhe procedurave për qëllim të përshtatjes me aktivitetet e Organizatës. Gjithashtu, QKRMT ka zhvilluar sistemin checks and balances, në mes të të gjithë organeve vendim-marrëse në organizatë.

Lidershipi dhe menaxhmenti

Lidershipi dhe menaxhmenti i organizatës, është përgjegjësi e drejtpërdrejt e Drejtorit Ekzekutiv, e/i cila/i i përgjigjet Bordit, ndërsa një herë në vit i raporton Kuvendit të Anëtarëve dhe është kryesisht përgjegjës për realizimin e planeve strategjike, politikave dhe ngritjen e fondeve. Përveç përgjegjësive të përmendura, Drejtori Ekzekutiv: në përputhje me statutin dhe programin e organizatës, e përfaqëson atë tek palët e treta, sipas nevojës inicion mbledhjet e Bordit, si dhe mbikëqyr çështjet teknike dhe administrative të organizatës.

Në vitin e kaluar, QKRMT ka riformatuar strukturën e re të organizimit të brendshëm, ku janë prezantuar tri shtresa të menaxhimit: Drejtor Ekzekutiv – Menaxhmenti i Lartë (programet) – Menaxhmenti i Projekteve.

I tërë grupi menaxhues i QKRMT përbëhet nga njerëz me eksperiencë profesionale, dhe ekspertizë në fushat përkatëse. Me qëllim të zhvillimit të një angazhimi sa më kreativ, lidershipi dhe menaxhmenti i QKRMT konsideron se vetë-vlerësimi, përmirësimi dhe mësimi i vazhdueshëm, janë vlerat kyçe të një menaxhimi të suksesshëm.

Rrjetëzimi

International Rehabilitation Council for Torture Victims, IRCT
<http://www.irct.org/>

Civikos Platforma
<http://www.civikos.net/>

Civic Solidarity Platform
<http://www.civicsolidarity.org/>

Rrjeti i Grave të Kosovës
<http://www.womensnetwork.org/>

International Detention Coalition
<http://www.idcoalition.org/>

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve, KOMF
<http://www.komfkosova.org/>



Donatorët

Falënderim i veçantë dhe mirënjohje të thellë shprehim për donatorët të cilët tanë. Ata asnjë herë nuk kanë hezitur të shprehin mbështetjen morale dhe financiare, mbështetje pa të cilën kjo përpjekje për shënimin e një triumfi final të drejtësisë dhe punës së OKRMT-së në përgjithësi, do të ishte e pamundur.

**SIGRID
RAUSING
TRUST**



British Embassy
Pristina



irct

International Rehabilitation
Council for Torture Victims



**Deaconess
Foundation**



The
CENTER for
VICTIMS of
TORTURE



Federal Foreign Office



QKRMT

Rr. Hamëz Jashari 16b/2
10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 38 243 707

E-mail: info@krct.org

web: www.krct.org



QKRMT-KRCT

Qendra Kosovare për Rehabilitimin
e të Mbijetuarve të Torturës

The Kosova Rehabilitation
Center for Torture Victims